



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 760 prot.

Tiranë, më 16. 05. 2022

V E N D I M

Nr. 85, datë 16. 05. 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi ankesën nr. 200, datë 03.11.2021, të K. K., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*¹” dhe “*çdo shkak tjetër*²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, ka filluar punë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (në vijim DPT) më datë 26.09.2016. Së fundmi, ka mbajtur detyrën e Inspektorit në Sektorin e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, Rajoni Verior në DPT.

Sipas ankuesit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve është referuar një denoncimin kundrejt tij, akt abuziv, rasti 79, datë 18.02.2021, ku pretendohet ndër të tjera se: “...*Denoncohet inspektor K. K., inspektor terreni i cili abuzon me ligjin në favor të interesave personale duke dëmtuar prej muajsh bizneset e Shkodrës dhe Lezhës, çështje e regjistruar me nr. 04 regj., datë 22.02.2021*”. Bazuar në këtë referim, Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion në DPT, ka nisur një verifikim në emër të ankuesit, për ndjekjen e këtij denoncimi.

¹ Referuar Kartës së Anëtarësimit të lëshuar nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim, datë 01.11.2016, Nr. 45209.

² Referuar faktit që motra e ankuesit, K. K. prej datës 14.10.2020, ka ushtruar funksionin e Kryetares së LSI-së, për Qarkun Durrës, dhe kandidate për deputete në zgjedhjet parlamentare 2021, për subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim.

Në përfundim të shqyrtimit të rastit, Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion (në vijim do ti referohemi DIBA), me shkresën nr. 3857, datë 02.03.2021, i ka propozuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për fillimin e ecurisë disiplinore, për punonjësit e Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren-Rajoni Qendror, si më poshtë:

- K. K., Inspektor në Sektorin e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, DVKT-RV;
- D. Zh., Inspektor në Sektorin e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, DVKT-RV;
- S. B., Inspektor në Sektorin e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, DVKT-RV;
- G. Z., Inspektor në Sektorin e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, DVKT-RV.

Sipas ankuesit, referuar tipologjisë dhe proceseve të punës, asnjë inspektor nuk del i vetëm në terren, por dalin në grupe kontrolli. Në këtë kuptim, nisja e verifikimit është bërë për të gjithë grupin e inspektorëve, por diferencimi sipas ankuesit është bërë vetëm në masat disiplinore të dhëna ndaj tyre. Kështu, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, pas hetimit disiplinor të kryer, ndaj ankuesit ka marrë masën disiplinore *“Largim nga detyra me pasojë “Zgjidhje e menjëhershme të marrëdhënieve të punës”*”, ndërsa për kolegët e tij, masën disiplinore *“Vërejtje me shkrim”*.

Përsa më sipër, ankuesi pretendon se nga mënyra e ndarjes dhe diferencimit të masave disiplinore, evidentohet jo vetëm se ndërmarrja e kontrollit dhe hetimit ishte i paligjshëm dhe i qëllimtë për të, por ka shkaktuar diskriminimin e tij, për shkak të *“bindjeve politike”*.

Në përfundim, ankuesi pretendon se motra e tij, që prej datës 14 Tetor 2020, ka ushtruar funksionin e Kryetares së LSI-së për Qarkun Durrës, dhe prej regjistrimit zyrtar të kandidatëve të partive politike për zgjedhjet e përgjithshme, ishte kandidatja e 5-të në listë për subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim, për këtë qark.

Periudha e angazhimeve të subjekteve politike në fushatën zgjedhore, përkon pikërisht me procesin e hetimit disiplinor të nisur ndaj tij, për ta larguar nga detyra. Sipas tij, ky proces, edhe pse i ndërmarrë sa për dukje, në formën e një kontrolli të përgjithshëm dhe për inspektorët e tjerë, rezultoi qartë se ka patur një qëllim të vetëm, sulmin ndaj tij, duke trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese, për shkak të perceptimit mbi bindjet e tij politike, si rezultat i angazhimit të familjarëve në jetën politike në vend.

Përsa më sipër, ankuesi pretendon se me anë të veprimeve të sipërcituara, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e kanë vënë në pozita diskriminuese për shkak të bindjeve politike, duke e larguar nga puna. Në këtë kuptim, ai kërkon nga Komisioneri, të konstatojë situatën diskriminuese dhe rikthimin e tij në pozicionin e mëparshëm të punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës nr. 1524/2 prot., datë 10.11.2021, Komisioneri i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (në vijim DPT) duke kërkuar informacion sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës³ së sipërcituar, DPT me shkresën nr. 20366/1 prot., datë 19.11.2021, vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera se: “...Me shkresën Nr. 3857 prot., datë 02.03.2021 “Konstatim i shkeljes disiplinore” të përgatitur nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) (në vijim DIBA), në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, vihemi në dijeni të shkeljes disiplinore të pretenduar për K. K., me detyrë Inspektor, në Sektorin e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, Rajoni Verior, për mospërbushje të detyrave dhe moszbatimin e dispozitave ligjore, bazuar kjo në Urdhërin Nr. 19/2, datë 28.04.2020 “Për miratimin e manualit të

³ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1524/3 prot., datë 06.12.2021

Hetimit Tatimor dhe manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren”, pasi punonjësi si përgjegjës i grupit të punës në kontrolllet e ushtruara në tatimpagues ka vepruar në kundërshtim me Kapitullin III, Sektori i Verifikimit dhe Monitorimit në Terren, Pika B, Verifikimi i deklaramit të punonjësve në organin tatimor, neni 119, si dhe Pika IV, Procedurat Administrative, Raportimi ditor dhe Pika VII, Programi ‘E-Inspektori’.

Informacioni për këtë shkelje disiplinore bazohet në denoncimin e ardhur në datë 18.02.2021, ku ndër të tjera pretendohet se inspektori K. K., abuzon me ligjin në favor të interesave personale duke dëmtuar prej muajsh bizneset e Shkodrës dhe të Lezhës, në përmbushje të detyrave funksionale duke kryer veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore të cilat janë trajtuar në propozimin e DIBA për fillimin e ecurisë disiplinore dhe konkretisht si më poshtë:

Në datën 23.02.2021, inspektorët e DIBA-s, janë paraqitur në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Verior, ku përveçse kanë ushtruar verifikim në lidhje me prezencën në punë të punonjësve dhe zbatimin e normave të Kodit të Etikës, kanë administruar edhe dokumentacionin lidhur me urdhërat e punës të nxjerrë për inspektorin K. K. si dhe Aktet e Konstatimit të mbajtura gjatë ushtrimit të kontrolleve ndaj tatimpaguesve për periudhën nga data 01.12.2020, deri në datën 25.01.2021.

Nga verifikimi i ushtruar në lidhje me prezencën në punë të punonjësve dhe zbatimin e normave të Kodit të Etikës, verifikimi i cili u krye në datë 18.02.2021, në orën 13:05 min., u konstatua se ndër të tjerë edhe K. K. nuk u gjend në vendin e punës.

Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) në DPT, në datën 23.02.2021, ka administruar nga Drejtoria e Verifikimit dhe Monitorimit në Terren Rajoni Verior, urdhërat e punës të nxjerrë nga kjo drejtori, në zbatim të Planit të Punës të DPT me Nr. 322 prot., datë 11.01.2021, në të cilët pjesëmarrës ka qenë K. K., me detyrë Inspektor në Sektorin e Verifikimit dhe Monitorimit në Terren.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se për periudhën nga data 01.12.2020, deri në datën 25.01.2021, janë nxjerrë 12 (dymbëdhjetë) urdhëra pune, për Qarkun Shkodër dhe Qarkun Lezhë, me pjesëmarrës inspektorët K. K., D. Zh., S. B. dhe G. Z.

Nga verifikimet e të gjitha Akt-Konstatimeve të mbajtura në zbatim të urdhërave të punës vërehet se në harkun kohor nga data 01.12.2020, deri në datën 25.01.2021, grupet me pjesëmarrës K. K., D. Zh., S. B. dhe G. Z., në asnjë rast nuk kanë zbatuar plotësisht sipas manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, urdhërat e punës, konkretisht: Pikën III. Objekti i Punës. Kontroll për verifikimin e deklaramit të punonjësve në organin tatimor.

Në të gjitha Akt-Konstatimet e verifikuara në harkun kohor nga data 01.12.2020, deri në datën 25.01.2021, inspektorët në lidhje me: Pikën III, Objekti i Punës, Kontroll për verifikimin e deklaramit të punonjësve në organin tatimor, të urdhërave të punës, shprehen se në punë gjenden punonjësit e subjektit, por inspektorët janë në pamundësi për verifikimin e tyre në sistemin tatimor C@TS.

Mosverifikimi i punonjësve të tatimpaguesve në sistemin C@TS nga ana e inspektorëve gjatë ushtrimit të kontrolleve në subjekte, konstatohet në të gjitha kontrolllet e ushtruara prej tyre. DIBA ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, Rajoni Verior, nëse për periudhën nga data 01.12.2020, deri në datën 31.01.2021, inspektorët e Sektorit të

Verifikimit dhe Monitorimit në Terren, gjatë ushtrimit të kontroleve nëse kanë qenë të pajisur me mjetet e nevojshme për t'u aksesuar në sistemin tatimor C@TS.

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, Rajoni Verior bën me dije se inspektorët pranë Sektorëve të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, janë pajisur me Tablete Smart si dhe kredencialet përkatëse për të aksesuar në sistemin tatimor C@TS.

Bazuar në Urdhërin Nr. 19/2, datë 28.04.2020 "Për miratimin e manualit të Hetimit Tatimor dhe manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren", dhe në mbështetje të nenit 119, të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Inspektorët e Sektorit të Verifikimit dhe Monitorimit në Terren, të autorizuar me shkrim, sipas urdhërit të shërbimit, punës, kryejnë verifikime e kontrole në vendndodhjen e biznesit lidhur me deklarin e të punësuarve, të të vetëpunësuarve, të punonjësve të papaguar të familjes, numrit të punonjësve (përgjegjësi grupit).

Para se të verifikojë numrin e të punësuarve në subjektet tatimpagues të zonës që i është caktuar, Inspektori i Sektorit të Verifikimit dhe Monitorimit në Terren, merr informacion të plotë dhe koherent nga sistemi tatimor C@TS, lidhur me deklarinet që kanë bërë ato biznese për numrin e deklaruar në organin tatimor (Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatim mbi të ardhurat nga punësimi), si edhe lëvizjet e të punësuarve ESIG 27-(Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe të larguarve nga puna), nëse është shkelje e mosdeklarimit të punonjësit për herë të parë apo/dhe të dytë, edhe emrat e të punësuarve sipas rastit të verifikimit në subjektin tatimpagues.

Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar:

a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 200 000 (dyqind mijë) lekë:

b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Së bashku me Akt Konstatimin edhe Procesverbali i gjobës mbahet menjëherë në vendushtrimin e veprimtarisë së tatimpaguesit dhe një kopje i lihet subjektit.

Vetëm në rastet e pamundësisë llogjike dhe praktike, kur tatim paguesi ushtron veprimtari në zona të thella, ku nuk ka dhe nuk funksionin interneti për të bërë të mundur në momentin e kontrollit të verifikimit të aksesit në sistemin C@TS, të përdorimit të Tabletës dhe zbatimin e Programit 'E-Inspektor', apo/dhe kur verifikimi kryhet në orar të vonë, dhe nuk është e mundur të merret informacion i saktë për rastin e shkeljes për punonjësit e deklaruar apo/fo edhe me Sektorin e Koordinimit, grupi i punës, do të njoftojë (me çdo lloj forme komunikimi) për këtë fakt Përgjegjësin, dhe më pas do të plotësojë në vend aktin e konstatimit (duke cilësuar faktin e pamundësisë së verifikimit të punonjësit dhe të një adrese elektronike e-maili të tatimpaguesit) duke përshkruar të gjithë punonjësit e konstatuar, me të dhënat personale përkatëse.

Gjithashtu, bazuar në Manualin e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, Pika V 'Procedurat administrative-Raportimi ditor', citohet se: Inspektori i SVMT (konkretisht përgjegjësi

i grupit të punës që ka qenë K. K.) e ka detyrë funksionale, menjëherë me hyrjen në subjekt, gjatë kryerjes së verifikimit dhe në fund të procedurës, zbatimin e manualit të Programit 'E-Inspektor' Mobile, për regjistrimin dhe kontrollin e bizneseve të taksueshme, nëpërmjet përdorimit të Tabletës dhe hedhjen e dokumentacionit sipas çështjeve (tatimpaguesve), në sistemin tatimor C@TS për çdo rast, kur ushtron kontroll verifikimi tek tatimpaguesi.

Ndër të tjera nga verifikimet e Akt-Konstatimeve vërehet se kontrollet në subjekt kanë zgjatur në harkun kohor mbi 30 minuta. Bazuar në Manualin e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, pika VII- Programi 'E-Inspektori', nën-pika 'Përcaktimi i Roleve në programin E-Inspektori dhe aksesit në secilin prej tyre', përcaktojnë/konfigurojnë njoftimet 'Inspektori të mos qëndrojnë më shumë se 30 minuta në një inspektim'.

Lidhur me qëndrimin e inspektorëve më shumë se 30 minuta pranë vendushtrimit të aktivitetit siç është përcaktuar në Manualin e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, është kërkuar nga DVKT në DPT, e cila informon se për çdo rast tejkalimi të këtij afatit grupi i punës ka detyrimin të njoftojë eprorin direkt lidhur me arsyet, e më tej të marrë konfirmimin nga ana e tij për të vijuar me verifikimin në vend (detyrë që duhet kryer nga K. K. si përgjegjës i grupit të punës).

Përgjegjësi i Sektorit të Verifikimit dhe Monitorimit në Terren, Rajoni Verior, pas informacionit të kërkuar nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion, ka sqaruar se nuk kemi asnjë komunikim zyrtar (e-mail) nga grupi i punës (K. K.) në lidhje me vonesat gjatë kontrolleve nga grupet e punës dhe arsyen e vonesës për rastet e kërkuara nga ana juaj.

Për këtë arsye, në zbatim të procedurave të përcaktuara në Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 'Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar, dhe nenin 32, 33 të Rregullores 'Për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil, në Administratën Tatimore Qendrore', miratuar me Urdhrin Nr. 10, datë 31.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm, ndaj K. K. ka filluar procedimi disiplinor me shkresën Nr. 3857/3 prot., datë 12.03.2021, me lëndë 'Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor për dhënie mase disiplinore', duke e njoftuar që të paraqitet në ballafaqim dhe të paraqesë argumentat e tij me shkrim në lidhje me këtë procedim disiplinor të filluar ndaj tij.

Në seancën e thirrur për ballafaqim me datë 18.03.2021, K. K. nuk është paraqitur duke njoftuar se është me raport mjeko ligjor, dhe pas kthimit në punë është thirrur në ballafaqim dhe është paraqitur me datë 22.06.2021 për të dhënë shpjegimet e tij për shkeljet e pretenduara si dhe ka dorëzuar edhe observacion.

Pas shqyrtimit të të gjitha pretendimeve, provave shkresore dhe argumentave të paraqitura nga subjekti në procedim disiplinor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nxjerrë vendimin Nr. 144, datë 30.06.2021, është marrë masa disiplinore 'Largim nga detyra me pasojë zgjidhje e menjëhershme e justifikuar e marrëdhënieve të punës' për K. K., duke u shprehur në dispozitivin e vendimit mbi të drejtën për ankim në gjykatë, nga marrja e tij për këtë vendim.

Shkaku i largimit nga puna ka qenë për arsye se në cilësinë e përgjegjës të grupit të punës, relatuar kjo në seancën dëgjimore edhe nga inspektorët pjesë e grupit të punës për detyrat konkrete që trajtuam më lart, detyra që kryhen vetëm nga përgjegjësi i grupit të punës dhe jo nga inspektorët e tjerë në grup pune, nuk ka vepruar në zbatim të detyrave të përcaktuara.

Përsa më sipër, pretendimet e ngritura nga K. K., nuk janë të bazuara, pasi shkak i largimit nuk ka lidhje me pjesën politike, kjo provohet edhe me faktin se K. K. nuk e ka ngritur as në observacionin e dorëzuar pranë Komisionit të Disiplinës, as në ballafaqimin gjatë seancës dëgjimore.

Pra shkak i largimit ka të bëjë me mospërmbushjen e detyrave funksionale dhe se vendimi për 'Zgjidhje të menjëhershme të justifikuar të marrëdhënies së punës' ndaj tij, është marrë në bazë të legjislacionit në fuqi dhe është konform çdo dispozite ligjore.

Ndër të tjera për informacion vlen të theksojmë se K. K. ka pasur një masë disiplinore të mëparshme në vitin 2017 me vendimin Nr. 710, datë 27.10.2017 'Vërejtje me shkrim' dhe ndërkohë ka qenë disa herë i propozuar për masë disiplinore si në vitin 2018 dhe në vitin 2020 me propozim nga eprori direkt dhe nga DIBA, ndaj pretendimi i tij për anësi politike nuk qëndron."

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, DPT vuri në dispozicion të KMD-së, një pjesë të informacionit të kërkuar.

2. Me anë të e-mail-it datë 10.12.2021, KMD vuri në dispozicion të palës ankuese, shkresën kthim përgjigje të DPT-së. Në përgjigje të pretendimeve të ngritura nga DPT, ankuesi me e-mail-in e datës 16.12.2021, sqaroi ndër të tjera se:

"Pikërisht nëpërmjet kësaj shkrese, por edhe në proces-verbalin nr. 4/1 të mbajtur në datën 29.06.2021, në mënyrë të qëllimtë dhe totalisht diskriminuese është tentuar të rëndohet pozita ime, duke mos pasqyruar të vërtetën për të justifikuar masat e diferencuara disiplinore që janë dhënë, duke më konsideruar si "përgjegjës grupi", ndërkohë që këtë cilësi nuk e kam patur kurrë as në aktin e emërimit dhe ushtrimit të funksionit, as në urdhërat e punës të nxjerrë nga DVT- Rajoni Verior, ku kam qenë i përfshirë e që jam marrë në verifikim. Bashkëngjitur po ju dërgoj një kopje të të gjithë Urdhërave të Punës për të cilat është ushtruar kontrolli dhe nga ku vërtetohet pozicioni im i punës. Për të gjitha të tjerat i qëndroj atyre që kam deklaruar në ankesën nr. 200, datë 03.11.2021, drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (rrethanat, faktet dhe të dhënat që tregojnë sjelljen diskriminuese). P.S. kopjen e denoncimit që ju ka dërguar Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është pa firmë të specialistit që e ka marrë."

3. Në këto kushte, për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës Nr. 96 prot., datë 13.01.2022 "Njoftim për seancë dëgjimore", Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 26.01.2022. Për shkak të pamundësisë⁴ së realizimit të seancës dëgjimore në këtë datë, me shkresën Nr. 318 prot., datë 15.02.2022, u vendos realizimi i saj më datë 21.02.2022.

⁴ Si rezultat i gjendjes shëndetësore të përfaqësuesve të KMD-së, së shkakuar nga Covid-19.

Seanca u zhvillua në datën e caktuar, me praninë e palëve: përfaqësueses⁵ të DPT-së dhe të ankuesit K. K..

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të mbahej në procesverbal dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Nga ana e ankuesit, u parashtrua ndër të tjera se, procedura e hetimit nga DIBA është iniciuar mbështetur në një denoncim anonim, në të cilin nuk specifikohet shkelja e kryer. Gjithashtu, sipas tij, në asnjë rast gjatë procedurës së ecurisë disiplinore, nga ana e komisioneve përkatëse nuk është evidentuar si përgjegjës i grupit të inspektimit. Edhe në shkresat e hartuara nga DIBA, ankuesi thekson se nuk i është dhënë një cilësim i tillë, si përgjegjës i grupit të inspektimit. Sipas tij, ai është emëruar si inspektor në DPT dhe në asnjë akt nuk citohet që mban detyrën e përgjegjësit të grupit. Ky cilësim, i është vendosur atij në mënyrë tendencioze për ta ngarkuar me përgjegjësi dhe për ta larguar nga puna.

Gjatë parashtrimeve të tij në seancë, ankuesi theksoi se është njohur për çdo hap të ndjekur sa i përket ecurisë disiplinore, por nuk ka qenë dakord në asnjë moment që ai ka qenë i vetmi ndaj të cilit është marrë masë disiplinore më e rëndë nga kolegët e tij, në momentin që ata kanë qenë në të njëjtat kushte me të. Gjithashtu, ai sqaroi se pretendimet e DPT-së sa i përket cilësimit nga kolegët si përgjegjës i grupit të inspektimit nuk qëndrojnë, pasi edhe në proceverbalet e ballafaqimit të tyre me punëdhënësin, ata në asnjë moment nuk e pretendojnë një gjë të tillë.

Sa i përket, vërejtjeve apo ecurive të tjera disiplinore të nisura, ankuesi theksoi se edhe ndaj kolegëve të tij është nisur ecuri disiplinore për të njëjtat shkelje të pretenduara, por për ta nuk janë marrë në konsideratë nga DPT, por vetëm për të. Ai cilësoi gjithashtu se ka patur një masë disiplinore në vitin 2018, e cila sipas legjislacionit në fuqi, është parashkruar dhe nuk duhet të qëndrojë në dosjen e tij.

Lidhur me bindjet politike ankuesi sqaroi se ai ka qenë anëtarë i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim që prej vitit 2016, por nuk i ka shprehur ato dhe nuk ka patur aktivitet politik publik. Nga muaji tetor 2020, motra e tij ka ushtruar funksionin e Kryetares së LSI-së për Qarkun Durrës, dhe prej regjistrimit zyrtar të kandidatëve të partive politike për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, ishte kandidatja e 5-të në listë për subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim, për këtë qark. Nga ky moment e në vijim, në disa raste i është dashur të mbështesë atë, si një familjar por jo në kuadër të fushatës zgjedhore dhe si pasojë nga ana e punëdhënësit është nisur procedura e ecurisë disiplinore. Pra, sipas tij zgjidhja e marrëdhënieve të punës ka ardhur menjëherë sapo u bë

⁵ Z. J. M., me detyrë Specialist në Drejtorinë Teknike dhe Ligjore, përfaqësuar me autorizim Nr. 1115, datë 24.01.2022.

publik fakti që e motra është pjesë e listës së kandidatëve për deputet, në qarkun e Durrësit, si pjesë e LSI-së.

Në vijim nga ana e përfaqësuesit të DPT-së, u kundërshtuan pretendimet e ankuesit dhe u sqarua se largimi i tij dhe inicimi i ecurisë disiplinore është bërë për shkak të shkeljeve të kryera në ushtrimin e funksionit dhe jo për shkaqet e pretenduara. Sipas tij, largimi nga pozicioni i punës është bërë për shkak të shkeljeve të gjetura në akt konstatimet dhe kontrollet e ushtruara nga grupi i inspektimit, në të cilin ai ka qenë në cilësinë e përgjegjësit të grupit. Shkeljet e konstatuara kanë përfshirë të gjithë grupin dhe për këtë shkak ndaj tyre është iniciuar ecuria disiplinore, por në dallim nga kolegët e tij, ankuesi në kushtet që ka qenë në cilësinë e përgjegjësit të grupit, ndaj tij është marrë masa disiplinore më e rëndë, ajo e largimit nga detyra. Nga ana e përfaqësuesit të DPT-së, u theksua se ndaj ankuesit janë nisur edhe më parë ecuri disiplinore për të cilat nuk është konkluduar në vendimmarrje, por që janë marrë në konsideratë nga ana e punëdhënësit lidhur me largimin nga puna.

Në përfundim të seancës, nga ana e përfaqësuesve të KMD-së, u kërkua që DPT në vijim të shqyrtimit të ankesës të vërë në dispozicion informacionin e mëposhtëm:

- Fakte dhe prova nëse anëtarët e tjerë të grupit të inspektimit, kanë patur masa disiplinore të tjera përpara dhe pas largimit të ankuesit nga pozicioni i punës;
- Fakte dhe prova nëse është iniciuar ecuria disiplinore për punonjës të tjerë të DPT-së, referuar denoncime verbale, si në rastin e ankuesit;
- Fakte dhe prova me anë të të cilave të vërtetohet pretendimi i DPT-së se ankuesi ka mbajtur pozicionin e përgjegjësit në grupin e inspektimit.

4. Pas seancës dëgjimore, me anë të e-mail-it datë 22.02.2022, ankuesi i është drejtuar KMD-së, duke informuar ndër të tjera se: *“Lidhur me çështjen në hetim nga ana e komisionerit, po ju bëj me dije dhe një tjetër informacion se sa jam diskriminuar në atë drejtori. Kam aplikuar për lejen vjetore të vitit 2020, afat që ishte deri në fund të muajit mars, dhe refuzonin të më jepnin përgjigje dhe në fund ma refuzonin dhe pse ishte e drejta ime. Aplikoja për lejen vjetore të vitit 2021 dhe bënë ping pong në drejtorinë e Burimeve Njerëzore në DPT, ndërkohë që e kishte kompetencë Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Shkodër. Gjithashtu, mund të gjeni e-mail-in në të cilin drejtoresha e Burimeve njerëzore në DPT, i drejton shefit E.N, dhe i shpjegon se miratimi i lejes vjetore nuk ishte në kompetencat e saja...Gjatë fushatës zgjedhore të dy nën drejtorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, kanë qenë të deleguar në Durrës, qytet ku motra ime është kryetare e LSI. Specifikisht A. Ç., i deleguar në lagjen 15 dhe 16, ish kënetë dhe K. Sh. në lagjen 12. Duket se dhe këtyre të dyve nuk u ka pëlqyer fakti që motra ime ishte kryetare LSI Durrës, e unë vëllai i saj. Në lidhje me njoftimin për raportin shëndetësor, bashkangjitur gjeni komunikimin dhe foton e raportit dërguar shefes së Sektorit të Kordinimit A.Z.”*

5. Më datë 11.04.2022, përfaqësuesi i DPT-së, J. M., depozitoi⁶ pranë KMD-së, një pjesë të informacionit të kërkuar nga ana e KMD-së, gjatë seancës dëgjimore. Ndër të tjera, DPT sqaroi se:

- *Nuk ka patur masa disiplinore në fuqi për inspektorët e tjerë të grupit të inspektimit ku bënte pjesë edhe ankuesi.*
- *Në lidhje me akte të cilat vërtetojnë që K. K. ka qenë përgjegjës grupi, K. K. ka orientuar, drejtuar dhe organizuar punën e grupit të inspektimit, kjo vërtetohet dhe me procesverbalin e takimit nr. 4, datë 22.06.2021 të firmosur nga ana e tij ku ka bërë me dije se: “Është njoftuar P/Sektorit. Kemi grup whatsapp që njoftojmë për çdo gjë. Rakordojmë gjithmonë”, duke zbatuar kështu de facto detyrat e përgjegjësit të grupit të cilat i ishin bërë me dije verbalisht”.*
- *Në lidhje me pretendimin e K. K. se është hequr nga puna për shkak të bindjeve politike dhe se motra e K. K. ka hedhur kantidaturën për deputete, sqarojmë se nga kërkimi në web të shtypit online rezulton se masa disiplinore ka filluar në datë 18.02.2021 kurse publikimi i emrit të motrës së paditësit për candidate e LSI është bërë në datë 17.03.2021.*
- *Në lidhje me pretendimin se paditësi është përgjuar nga kamerat në rrethin e Durrësit, nuk qëndron pasi procedurat në lidhje me komisionin kishte filluar me përpara dhe nuk mund të vërtetohet në asnjë mënyrë se kjo ka patur ndikim në procedurë.*

6. Përsa më sipër Komisioneri, me anë të e-mail-it datë 11.04.2022, i përcolli subjektit ankues parashtrimet e vëna në dispozicion Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Në përgjigje përsa sipërcituar, ankuesi me e-mail-in datë 14.04.2022, sqaroi ndër të tjera se: “

1. Aktet e ngjashme për largim nga puna me anë të denoncimit nuk janë aspak të ngjashme sepse:
1.1. Janë konstatuar në moment, në subjekt në shkelje duke ngrënë në Restorant në zonën që kishin për kontroll. 1.2. Janë konstatuar në moment të larguar nga vendi i punës në subjektin që duhet të kontrolloinin. 1.3. Asnjëri nga inspektorët e larguar nga puna nuk është cilësuar Përgjegjës Grupi. 1.4. Për çudi denoncimi për mua përfshin dy qarqe Shkodër-Lezhë e asnjë emër konkret subjekti si në rastet e sipërcituara.

2. Në Manualin e Drejtorisë së Verifikimit dhe Kordinimit në Terren, kopje të të cilit jua ka vënë në dispozicion DPT, është e specikuar qartë si ndahen detyrat faqja 44.

3. Masa disiplinore në fuqi nuk kam pasur, as unë as inspektorët e tjerë, kjo vërtetuar dhe me shkresën nr. 5163/1, datë 08.04.2022, por kanë marrë mbrapa masa disiplinore për shkelje dhe më të rënda që përbëjnë dhe veper penale dhe përsëri janë mbajtur në punë duke vërtetuar përsëri veprimet e njëanshme me dy standarte dhe diskriminuese ndaj meje.

4. Komunikimi me përgjegjësin e sektorit nuk të bën as de juro as de facto përgjegjës grupi, por të bën emërimi në detyrë në rrugë shkresore ose urdhëri i punës.

⁶ Gjatë takimit u mbajt procesverbali datë 11.04.2022, ndërmjet inspektorit të çështjes dhe përfaqësuesit të DPT-së.

5. *Ky diskriminim në mënyrë kaq të hapur ka filluar që kur motra ime ka marrë detyrën e Kryetares së LSI Durrës dhe jo si përpigjen ta kamuflonjë DPT. Bashkangjitur kopje nga web e Gazetës Shqip dt. 14.10.2020”.*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Mbështetur në provat e administruara, ankuesi, ka filluar punë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve më datë 26.09.2016. Së fundmi, ka mbajtur detyrën e Inspektorit në Sektorin e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, Rajoni Verior në DPT.

Në pozicionin e sipërcituar, ankuesi ka punuar nga data 26.08.2016 deri në datën 30.06.2021, kur i është zgjidhur kontrata e punës, bazuar në Vendimin nr. 144, datë 30.06.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Në përfundim, ankuesi pretendon se motra e tij, që prej datës 14 tetor 2020, ka ushtruar funksionin e Kryetares së LSI-së për qarkun Durrës, dhe prej regjistrimit zyrtar të kandidatëve të partive politike për zgjedhjet e përgjithshme, ishte kandidatja e 5-të në listë për subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim, për këtë qark.

Përsa më sipër, ankuesi pretendon se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e ka vënë në pozita diskriminuese për shkak të bindjeve politike, duke e larguar nga puna.

Nga palët në proces është vënë në dispozicion të shqyrtimit të çështjes, informacion se ankuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt: *“Konstatimi si zgjidhje e menjëhershme dhe e pa justifikuar të kontratës së punës nga punëdhënësi dhe pagimin e dëmshpërblimit prej 1 vit pagë. Dëmshpërblimin me pagën e dy muajve për mosrespektim të afatit të njoftimit. Dëmshpërblimin me pagën e dy muajve për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës. Shpërblimin me 2 muaj e gjysëm pagë për vjetërsinë në punë.”*

Në referencë të nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile ku përcaktohet se: *“Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”,* Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, do të vijojë shqyrtimin e çështjes sa i përket pretendimit të diskriminimit, lidhur me arsyet e përdorura nga ana e DPT-së gjatë procedurës së ecurisë disiplinore dhe zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës Nr. 200, datë 30.11.2021, Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

Në vlerësim të pretendimeve të ankuesit, Komisioneri ka çmuar të shqyrtojë dhe analizojë ankesën, lidhur me arsyet e përdorura nga ana e DPT-së gjatë procedurës së ecurisë disiplinore dhe arsyet e zgjidhjes përfundimtare të marrëdhënieve të punës.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet se: “1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.”

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në bindjet politike, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë këtu pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.

Bazuar në pikën 5, germa “c”, të nenit 9, të Kodit të Punës, që përbën dhe legjisllacionin mbi bazën e të cilit rregullohet marrëdhënia e punësimit në rastin konkret, parashikohet se: “Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:..c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin në të drejtën e tij për punësim, duke përfshirë këtu edhe momentin e përfundimit e marrëdhënieve të punës;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për punësim dhe më konkretisht në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës.

Secila nga palët në një marrëdhënie punësimi ka të drejtën që të zgjidhë kontratën e punës në mënyrë të njëanshme. Kodi i Punës parashikon rregullat, procedurat dhe afatet që duhet të respektohen nga palët të cilat kanë hyrë në një marrëdhënie juridike punësimi dhe kanë lidhur midis tyre kontratën individuale të punës. Kodi i Punës parashikon dy mënyra të zgjidhjes së kontratës së punës, zgjidhjen normale dhe zgjidhjen e menjëhershme. Në të dyja rastet palët kanë detyrimin që të respektojnë procedurën dhe afatet e përcaktuara.

Referuar akteve të administruara, rezulton se:

Mbështetur në Formularin “*Informacion mbi rastin abuziv*”, nr. 79, datë 18.02.2021, një qytetar i paidentifikuar, nëpërmjet kontaktit telefonik, ka kontaktuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, dhe ka pretenduar se: “*Denoncohet inspektor K. K., inspektor terreni, i cili abuzon me ligjin në favor të interesave personale duke dëmtuar prej muajsh bizneset e Shkodrës dhe të Lezhës*”.

Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion në DPT, në përmbushje të detyrave të saj funksionale ka nisur procedurën e shqyrtimit të denoncimit të sipërcituar të qytetarit dhe më datë 23.02.2021, inspektorët e DIBA-s, janë paraqitur pranë Drejtorisë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Verior, ku kanë ushtruar verifikim në lidhje me prezencën në punë të punonjësve dhe zbatimin e normave të Kodit të Etikës. Gjatë kontrollit, kanë administruar edhe dokumentacionin lidhur me urdhërat e punës të nxjerr për inspektorin K. K., dhe Aktet e Konstatimit të mbajtura gjatë ushtrimit të kontrolleve ndaj tatimpaguesve nga ana e tij për periudhën nga data 01.12.2020, deri në datën 25.01.2021.

Gjatë kontrollit të ushtruar nga DIBA, në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Verior, ndër të tjera është konstatuar mosprezenca në punë e subjektit ankues. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar, DIBA ka konstatuar ndër të tjera se: “*...grupet e punës me pjesëmarrës K. K., D. Zh., S. B. dhe G. Z., me detyra Inspektor në Sektorin e Verifikimit dhe Monitorimit në Terren në DVKT-Rajoni Verior, në asnjë rast nuk kanë zbatuar plotësisht sipas manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, Urdhërat e punës, konkretisht: Pikën III Objekti Punës. Kontroll për verifikimin e deklaramit të punonjësve në organin tatimor*”.

Mbështetur në shkeljet e konstatuara, DIBA i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së me shkresën Nr. 3857 prot., datë 02.03.2021, duke i propozuar fillimin e ecurisë disiplinore për inspektorët K. K., D. Zh., S. B. dhe G. Z., me argumentimin se: *“...bazuar në “Urdhër nr. 19/2, datë 28.04.2020, “Për miratimin e manualit të Hetimit Tatimor dhe manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren”, inspektorët e Sektonit të Verifikimit dhe Monitorimit në Terren, në DVKT-Rajoni Verior, K. K., D. Zh., S. B. dhe G. Z., kanë vepruar në kundërshtim me: - Kapitullin III. Sektori i Verifikimit dhe Monitonimit në Terren, - Pika B. Verifikimi i deklarimit të punonjësve në organin tatimor neni 119, - Pika IV. Procedurat Administrative-Raportixni ditor dhe - Pika VII. Programi “E-Inspektori”.*

Përsa më sipër, me shkresën Nr. 3857/3 prot., datë 12.03.2021, me lëndë *“Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor për dhënie mase disiplinore”*, DPT ka njoftuar ankuesit që të paraqitet në ballafaqim dhe të parashtojë argumentat e tij me shkrim në lidhje me këtë procedim disiplinor të filluar ndaj tij.

Në seancën e thirrur për ballafaqim me datë 18.03.2021, K. K. nuk është paraqitur duke njoftuar se është me raport mjeko ligjor, dhe pas kthimit në punë është thirrur në ballafaqim dhe është paraqitur me datë 22.06.2021 për të dhënë shpjegimet e tij për shkeljet e pretenduara si dhe ka dorëzuar edhe observacion.

Pas shqyrtimit të të gjitha pretendimeve, provave shkresore dhe argumentave të paraqitura nga subjekti në procedim disiplinor, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve me Vendimin Nr. 144, datë 30.06.2021, është marrë masa disiplinore *“Largim nga detyra me pasojë zgjidhje e menjëhershme e justifikuar e marrëdhënieve të punës”* për K. K.

Sipas DPT-së, shkaku i largimit nga puna ka qenë për arsye se në cilësinë e përgjegjës të grupit të punës, relatuar kjo në seancën dëgjimore edhe nga inspektorët pjesë e grupit të punës për detyrat konkrete, detyra që kryhen vetëm nga përgjegjësi i grupit të punës dhe jo nga inspektorët e tjerë në grup pune, nuk ka vepruar në zbatim të detyrave të përcaktuara. Pra, sipas DPT-së, shkaku i largimit ka të bëjë me mospërbushjen e detyrave funksionale nga ana e subjektit ankues.

Me Urdhrin nr. 19/2, datë 28.04.2020, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar Manualin e Hetimit Tatimor dhe Verifikimit dhe Koordinimit në Terren. Në Kapitullin II, të këtij manuali parashikohet Sektori i Trajtimit të Ankesave, i cili ka në funksion të tij: *“...mbledhjen e informacionit e të dhënave për rastet abuzive që vijnë nga ankesat dhe burime të ndryshme denoncimi, për shkelje administrative tatimore të kryera nga veprimtaria e tatimpaguesve apo edhe shkeljet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe funksionit nga punonjësit e sektorit të verifikimit dhe monitorimit në terren në marrëdhënien me tatimpaguesin. Përgatitjen e një informacioni të evidentuar dhe të detajuar sipas çdo rasti abuziv dhe ankese duke e raportuar tek Drejtori i Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT, me qëllim përcaktimin e mënyrës dhe sektorin përkatës për ndjekjen e mëtejshme të verifikimit, marrjen e masave administrative tatimore për shkeljet e konstatuara dhe raportimin e ankesës/rastit abuziv, me qëllim rritjen e*

efektivitetit në kontrollin e zbatimit të legjislacionit tatimor dhe në respektim të bashkëpunimit dhe shërbimit ndaj qytetarit.”

Në vijim Manuali përcakton se si mund të paraqiten rastet abuzive nga ankesat apo denoncimet pranë Sektorit të Trajtimit të Ankesave:

- në rrugë elektronike (telefon, e-mail, Whatsapp, Viber);
- në rrugë postare;
- nga komunikimet e drejtpërdrejta.

Gjithashtu, cilat raste abuzive nga ankesat apo denoncimet ndiqen nga Sektori i Trajtimit të Ankesave, si:

- Linja e gjelbër 0800 1414;
- Adresa elektronike e DPT (denoncimetatime.gov);
- Aplikacioni “Stop Informalitetit” pranë Kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT;
- Adresën postare të DPT-së;
- Me takim të drejtpërdrejtë në DPT;
- Portali “Platforma e Bashkëqeverisjes”, funksionon sipas rregullave të veçanta të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

Në paragrafin e fundit të Kapitullit II të manualit përcaktohet se: *“Kur denoncuesit nuk japin të dhëna të sakta për objektin e denoncimit apo adresën e subjektit, iu kërkohet nga ana e tyre një informacion shtesë më i detajuar. Nëse nuk sillen ky informacion shtesë, raste të tilla administrohen në një dosje të veçantë, arshivohen me një relacion sqarues dhe këto raste nuk ndiqen”.*

Në analizë përse më sipër, evidentohet se Manuali i Hetimit Tatimor dhe Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, përcakton në mënyrë të qartë mënyrat, ndjekjen e mëtejshme të verifikimit, marrjen e masave administrative tatimore për shkeljet e konstatuara dhe raportimin e ankesës/rastit abuziv. Në çdo rast Manuali ka të parashikuar se, kur denoncuesit nuk japin të dhëna të sakta për objektin e denoncimit apo adresën e subjektit, iu kërkohet nga ana e tyre një informacion shtesë më i detajuar. Nëse nuk sillen ky informacion shtesë, raste të tilla administrohen në një dosje të veçantë, arshivohen me një relacion sqarues dhe këto raste nuk ndiqen.

Pra në këtë kuptim, denoncimi i bërë për raste abuzive duhet të ketë të dhëna të sakta lidhur me objektin e tij apo adresën e subjektit, në të kundërt nuk duhet vijuar me ndjekjen e tij. Në rastin e denoncimit të ardhur kundrejt ankuesit, DPT, nuk rezulton të ketë ndërmarrë asnjë masë për plotësimin e informacionit/denoncimit dhe verifikimin nëse përmban elementët e plotë për tu ndjekur, siç është parashikuar në Manualin e Hetimit Tatimor dhe Verifikimit dhe Koordinimit në Terren. Denoncimi i bërë nuk përmbante të dhëna të sakta për objektin e denoncimit apo adresën e subjektit, duke përgjithësuar se ankuesi është në favor të interesave personale ka dëmtuar prej muajsh bizneset e Shkodrës dhe të Lezhës, pa specifikuar se cilat janë këto biznese. Në këtë kuptim, Komisioneri vlerëson se verifikimi i kryer në rastin konkret për ankuesin, nuk është iniciuar konform Manualit të Hetimit Tatimor dhe Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.

Lidhur me trajtimin në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm, të ankuesit krahasuar me kolegët e tij, Komisioneri vlerëson si më poshtë.

Nga analiza e provave të administruara, rezultoi se nga ana e DIBA-s me shkresën Nr. 3857 prot., datë 02.03.2021, është propozuar fillimi i ecurisë disiplinore për inspektorët: K. K., D. Zh., S. B. dhe G. Z., si rezultat i mospërmbushtjes së detyrave funksionale gjatë ushtrimit të detyrës. Nga përmbajtja e kësaj shkrese, në asnjë moment ankuesi nuk është cilësuar si përgjegjës i grupit të inspektimit, por referohet si *“Inspektor në Sektorin e Verifikimit dhe Monitorimit në Terren”*.

Gjithashtu, ankuesi është cilësuar në çdo akt të vënë në dispozicion nga palët si *“Inspektor në Sektorin e Verifikimit dhe Monitorimit në Terren”*. Për këtë, Komisioneri vlerësoi dokumentacionin sa i përket:

- ecurisë disiplinore dhe shkresave⁷ me lëndë *“Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor për dhënie mase disiplinore”* drejtuar ankuesit dhe 3 (tre) kolegëve të tij, ku evidentohet se ata cilësohen si *“Inspektor në Sektorin e Verifikimit dhe Monitorimit në Terren”*;
- procesvebalet e mbajtura nga Komisioni Disiplinor, i cili ka shqyrtuar ecurinë disiplinore, nuk rezulton që ankuesi apo kolegët e tij të jenë shprehur në ndonjë moment se cili prej tyre e ka ushtruar detyrën e përgjegjësit të grupit gjatë ushtrimit të detyrave funksionale;

Me Urdhrin nr. 19/2, datë 28.04.2020, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar. Në Kapitullin III, pika V të Manualit të Hetimit Tatimor dhe Verifikimit dhe Koordinimit në Terren përcaktohet ndër të tjera se: *“Gjatë kryerjes së detyrës funksionale të veprimeve në terren për zbatimin e Urdhërit të Punës, inspektorët e SVMT, duhet të jenë të pajisur me: Urdhër Pune...Në Urdhër Pune duhet të jenë të pasqyruar dhe të përcaktuar: ...-Pjesëmarrësit e zbatimit të urdhërit të punës: SVMT (emër, mbiemër dhe të specifikuar funksionin e secilit, përgjegjës, inspektor);...”*

Komisioneri gjatë shqyrtimit të ankesës, por edhe gjatë seancës dëgjimore i ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, prova dhe fakte me anë të të cilave të vërtetohet pretendimi i tyre se ankuesi ka mbajtur rolin e përgjegjësit të grupit të inspektimit, por nga ana e saj nuk është vënë në dispozicion asnjë informacion me anë të të cilit të argumentohet pretendimi i tyre. Pavarësisht parashikimit në Kapitullin III, pika V të Manualit të Hetimit Tatimor dhe Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, në asnjë nga urdhrat e punës të vendosura në dispozicion të Komisionerit, nuk rezulton që ankuesi të jetë cilësuar në pozicionin e përgjegjësit të

⁷ Shkresës Nr. 3857/3 prot., datë 12.03.2021 *“Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor për dhënie mase disiplinore”*, drejtuar K. K.

Shkresës Nr. 3857/1 prot., datë 12.03.2021 *“Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor për dhënie mase disiplinore”*, drejtuar D. Zh.

Shkresës Nr. 3857/4 prot., datë 12.03.2021 *“Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor për dhënie mase disiplinore”*, drejtuar G. Z.

Shkresës Nr. 3857/2 prot., datë 12.03.2021 *“Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor për dhënie mase disiplinore”*, drejtuar S. B.

grupit. Në këtë kuptim, pretendimi se ankuesi ka qenë përgjegjës i grupit të inspektimit, është i pa mbështetur në provat dhe faktet e vëna në dispozicion nga palët.

Nga analiza e bërë dokumentacionit dhe provave sa i përket vlerësimeve të punës të ankuesit dhe kolegëve të tij, gjatë periudhës 2018-2020 rezultoi se:

- K. K. në vitin 2018 është vlerësuar me 2 (mirë); në vitin 2019 është vlerësuar dy herë gjatë vitit, një herë me 2 (mirë), gjatë 6-mujorit të I-rë dhe me 3 (kënaqshëm) gjatë 6 mujorit të II-të; **në vitin 2020 është vlerësuar me 1 (shumë mirë);**
- D. Zh., në vitin 2018 është vlerësuar me 2 (mirë); në vitin 2019 është vlerësuar dy herë gjatë vitit me 2 (mirë); **në vitin 2020 është vlerësuar me 2 (mirë);**
- S. B., në vitin 2018 është vlerësuar me 2 (mirë); në vitin 2019 është vlerësuar dy herë gjatë vitit me 2 (mirë); **në vitin 2020 është vlerësuar me 2 (mirë);**
- G. Z., ka vetëm një vlerësim pune **gjatë vitit 2020 me 2 (mirë);**

Referuar vlerësimeve të punës analizuar më sipër, vërehet se për periudhën janar-dhjetor 2020, ankuesi është i vetmi inspektor nga grupi i punës, i cili ka marrë vlerësimin maksimal nga eprorët e tij me 1 (shumë mirë).

Sa i përket pretendimit të paraqitur nga ankuesi lidhur me mospagesën e raportit mjekësor të datës 23.02.2021, Komisioneri vlerësoi se:

- Nga komunikimi në aplikacionin Whatsapp të mbajtur ndërmjet ankuesit dhe shtetases A., evidentohet se ankuesi më datë 26.02.2021, ka dërguar me foto raportin mjekësor me numër regjistri 1175, datë 23.02.2021. Pavarësisht këtij fakti, nga provat e administruara Komisioneri nuk arrin të dokumentojë/provojë faktin nëse shtetësja A., është punonjëse pranë DPT-së dhe mban rolin apo është personi përgjegjës i ngarkuar nga punëdhënësi në strukturat e burimeve njerëzore;
- Nga informacioni i dhënë nga ankuesi gjatë seancës dëgjimore, ai sqaroi se pavarësisht faktit që raportin mjekësor nuk i është marrë parasysh nga punëdhënësi, ai nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të kërkuar arsyet e këtij veprimi.

Në përfundim përsa më sipër, Komisioneri nuk administroi prova dhe fakte të mjaftueshme, për të konstatuar nëse ankuesi është vënë në kushte të pafavorshme apo është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë sa i përket mospagesës së raportit mjekësor të datës 23.02.2021.

Sa i përket pretendimit të paraqitur nga ankuesi lidhur me mosdhënien e lejes vjetore të vitit 2021, Komisioneri vlerësoi se:

- Nga informacioni i administruar, ankuesi më datë 18.03.2021, ka kërkuar nga punëdhënësi me anë të e-mail-it, shfrytëzimin e lejes vjetore të paguar të vitit 2021, por nuk i është miratuar. Nga kqyrja e e-mail-eve të vëna në dispozicion nga ankuesi, rezulton që punëdhënësi me datë

01.04.2021, i ka sqaruar ankuesit se kërkesa e lejes nuk është miratuar për shkak se ndaj tij është nisur procedura disiplinore.

- Gjithashtu, me anë të e-mail-it të datës 01.04.2021, nga ana e eprorit direkt, shtetasit D. D., ankuesi është vënë në dijeni të faktit se për shkak të procedurës disiplinore të nisur për të dhe inspektorët/kolegët e tjerë, punëdhënësi nuk ka kthyer përgjigje për aprovimin e lejes vjetore të tyre.

Përsa më sipër, Komisioneri vlerësoi se, pavarësisht pretendimit të ngritur nga ankuesi, nuk rezulton se kolegët apo inspektorët e tjerë ndaj të cilëve ishte nisur procedura disiplinore, të kishin shfrytëzuar lejen vjetore të paguar gjatë periudhës së ecurisë disiplinore. Në këtë kuptim, Komisioneri nuk administroi prova dhe fakte të mjaftueshme, për të konstatuar nëse ankuesi është vënë në kushte të pafavorshme apo është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë sa i përket mosdhënies së lejes vjetore gjatë periudhës së procedurës disiplinore të nisur ndaj tij dhe kolegëve/inspektorëve të tjerë.

Nga analiza e bërë dokumentacionit dhe provave sa i përket ecurisë disiplinore të ankuesit dhe kolegëve të tij, gjatë periudhës 2018-2020 rezultoi se:

- Ndaj K. K., gjatë periudhës 2018-2020, është iniciuar nga punëdhënësi procedim disiplinor në 4 (katër) raste, 1 (një) në vitin 2018, 1 (një) në vitin 2019 dhe 2 (dy) në vitin 2020. Nga këto, ndaj ankuesit nuk është marrë masë disiplinore në asnjë rast. Në 3 (tre) nga rastet e sipërcituara, ankuesi rezulton të ketë qenë në grup me inspektorin D. Zh. Nga dokumentacioni evidentohet se procedura disiplinore ka nisur pasi për të dy inspektorët është pretenduar se janë gjetur në shkelje gjatë ushtrimit të detyrës;
- Në 1 (një) rast (sipërcituar) ndaj ankuesit rezulton të jetë propozuar masë disiplinore me argumentin e mospërmbushjes së objektivave, performancë të ulët në punë, në muajin Maj 2020 dhe vlerësim me një mesatare ditore 2.2. Nga kqyrja e provave të vëna në dispozicion, rezulton që inspektorët S. B. dhe D. Zh., për të njëjtën periudhë janë vlerësuar me 2.1 nga ana e eprorëve të tyre. Pra, nga analiza e bërë dokumentacionit të depozituar, rezulton se ata kanë patur një performancë më të ulët se ankuesi dhe nuk është vënë në dispozicion informacion, nëse edhe ndaj tyre është propozuar masë disiplinore si në rastin e K. K., pavarësisht se është kërkuar nga KMD gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës;
- Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga ana e ankuesit, rezulton se me shkresën nr. 13726/1 prot., datë 22.07.2021, DIBA i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, duke i propozuar fillimin e ecurisë disiplinore për punonjësit: E. N., Përgjegjës i Sektorit të Verifikimit dhe Monitorimit në Terren dhe inspektorëve D. Zh., S. B. dhe A. J. Inspektorët D. Zh. dhe S. B., kanë qenë pjesë e grupit të punës të cilët ndodheshin në të njëjtat kushte me ankuesin, sa i takon procedurës së ecurisë disiplinore. Shkaku i propozimit të fillimit të ecurisë disiplinore ndaj tyre lidhej me shkeljet e konstatuara nga DIBA, gjatë ushtrimit të detyrës nga ana e tyre në muajin Maj 2021. Pavarësisht fillimit të ecurisë disiplinore, për këto shkelje ndaj punonjësve të sipërcituar nuk është marrë asnjë masë disiplinore nga DPT-së.

Përsa më sipërcituar dhe në analizë të pretendimeve të DPT-së, ankuesi nuk ka qenë i vetmi nga grupi i punës, ndaj të cilit ka patur masa disiplinore të mëparshme. Në të njëjtat kushte me të rezultojnë të ketë qenë të paktën edhe një prej kolegëve të tij, inspektori D. Zh.

Lidhur me argumentat e parashtruara, Komisioneri ka vlerësuar se ato janë të pabazuara dhe nuk qëndrojnë, për arsye se, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve:

- Pavarësisht parashikimit në Kapitullin III, pika V të Manualit të Hetimit Tatimor dhe Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, në asnjë nga urdhrat e punës të vendosura në dispozicion të Komisionerit, nuk rezultojnë që ankuesi të jetë cilësuar në pozicionin e përgjegjës të grupit. Në këtë kuptim, pretendimi se ankuesi ka qenë përgjegjës i grupit të inspektimit, është i pa mbështetur në provat dhe faktet e vëna në dispozicion nga palët;
- Referuar parashkrimeve të ngritura nga DPT dhe provave të administruara, nuk rezultojnë që në raport me inspektorët e tjerë të grupit të punës, ndaj ankuesit të ketë patur masa disiplinore të mëparshme në fuqi, të cilat kanë ndikuar në marrjen e masës disiplinore të largimit nga puna të ankuesit, krahasuar me kolegët e tij. Në këtë kuptim, edhe pse ankuesi ka qenë në të njëjtat kushte me të paktën një prej kolegëve, inspektorin D. Zh., vetëm ndaj tij është marrë masa disiplinore e largimit nga puna, kur nga aktet dhe provat e administruara nuk rezultojnë në asnjë moment që ai të ketë qenë i vetmi inspektor i grupit që ka patur përgjegjësi për shkeljet e konstatuara nga DIBA;
- Pavarësisht se ankuesi ka qenë i vetmi nga inspektorët e grupit që ka patur vlerësimin e fundit të punës maksimal, me 1 (shkëlqyeshëm), ky fakt nuk është marrë në konsideratë nga punëdhënësi gjatë procedurave të ecurisë disiplinore.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se, arsyet e deklaruara nga punëdhënësi për largimin nga puna, rezultuan të paprovuara. Në këto kushte provohet se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme, krahasuar me kolegët e tij të grupit gjatë procedurës së për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, pasi pavarësisht se ndodheshin në të njëjtat kushte, vetëm për të u mor masa disiplinore më e rëndë, ajo e largimit nga puna. Në përfundim, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues, është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁸, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ky ligj, ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një

⁸“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Mbështetur në nenin 9/2 të Kodit të Punës, mbrojtja nga diskriminimi garantohet bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar se: *“Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët”.*

Në të drejtën ndërkombëtare, shpesh përdoret termi *mendimi politik dhe tjetër* (ang. *Political and other opinion*), dhe me këtë përfshihet dhe përkatësia politike. Përkatësia politike duhet të interpretohet në mënyrë që të mbulojë lidhshmërinë me ndonjë opion të caktuar politik ose parti politike, me të cilën do t'i përfshijë dhe rastet kur bëhet fjalë për përkatësinë formale (anëtarësinë), por dhe llojet e tjera të lidhjeve, përmes të cilave mund të tregohet lidhshmëri me ndonjë parti ose opion tjetër politik. Me qëllim interpretimi sa më gjithëpërfshirës të këtij shkakui, i cili duhet të jetë në pajtueshmëri me të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare, rekomandohet që në këtë shkak të përkatësisë politike, të përfshihen rastet e anëtarësisë formale ose joformale dhe llojet e tjera të lidhjes me partitë politike.

Këtë qëndrim mban dhe Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, e cila, në vendimin nr. 31/2021, në pikën 67, të tij, shprehet se: *“...nacioni bindje politike përfshin jo vetëm shprehjen e pikëpamjeve politike dhe pjesëmarrjen në debatin politik apo inkuadrimit, organizimin kolektivisht ose pjesëmarrjen në organizata apo parti politike, por edhe të drejtën për të pasur ide ose pikëpamje që nuk bëjnë pjesë në ndonjë platformë apo program të partive politike, si dhe të drejtën për të mos iu bashkuar strukturave të organizatave ose partive politike. Në këtë kuptim, trajtimi i njëjtë nga pjesa e dispozitës ligjore të kundërshtuar i subjekteve që ndodhen në situata faktike të ndryshme për shkak të bindjeve politike, përbën diskriminim të padrejtë, për të cilin, ashtu siç u arsyetua më lart në këtë vendim, nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”.*

Ankuesi ka pretenduar diskriminim edhe për shkak të “*bindjes politike*” duke shpjeguar se zgjidhja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, duke ju referuar faktit që është anëtar në subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim, provuar me kartën e anëtarësisë datë 01.11.2016, Nr. 45209.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të faktit që motra e tij, K. K. prej datës 14.10.2020, ka ushtruar funksionin e Kryetares, si dhe ka qenë kandidatë për deputete në zgjedhjet parlamentare, për subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim, për qarkun Durrës, Komisioneri vëren se “*lidhjet familjare*” të ankuesit me shtetasen K. K. shërbejnë si provë për të faktuar lidhjen e tyre, në kuadër të shoqërimit apo supozimit për shoqërim të tyre, gjë që do të shtjellohet më poshtë në vendim në kuadër të diskriminimit për shkak të shoqërimit, dhe nuk qëndrojnë si shkak më vehte.

Rezulton se, përpara periudhës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në prill të vitit 2021, e motra e ankuesit, znj. K. K., referuar publikimeve të bëra në media, më datë 14.10.2020, është emëruar⁹ në pozicionin e Kryetares së subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, për Qarkun Durrës. Gjithashtu, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, znj. K. K., ka qenë kandidatë¹⁰ për deputete e LSI-s në Qarkun e Durrësit.

Rezulton gjithashtu se, znj. D. I. është emëruar nga Kryeministri i Shqipërisë në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve më datë 15.07.2019. Gjithashtu, bazuar në publikimet e faqes zyrtare të Partisë Socialiste të Shqipërisë¹¹, në kategorinë “*Familja Jonë*”, znj. D. I., rezulton të jetë pjesë e strukturave të saj. Referuar aktivitetit politik të bërë publik¹² në media, znj. D. I., rezulton të jetë e deleguara e PS në Njësinë Nr. 5, në Tiranë.

Kodi i Procedurës Administrative, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: “*Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme*”.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, aktiviteti dhe bindjet politike të kundërta të motrës së subjektit ankues dhe të znj. D. I., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, janë fakte të njohura botërisht dhe nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.

⁹ <https://www.gazetatema.net/2020/10/14/pas-tradhetise-se-lefter-kokes-lsi-emeron-drejtuesit-e-rinj-ne-durres-ja-emrat>

¹⁰ <https://telegraf.al/politike/lsi-durres-kontjana-kuci-kapitullimi-perfundimtar-i-rilindjes-vjen-me-25-prill/>

¹¹ <https://www.ps.al/familja-jone/delina-ibrahimaj>

¹² <https://www.faxweb.al/rama-ben-ndryshime-te-te-deleguarve-per-tiranen-marrin-bazen-ne-dore-lindita-nikolla-orlando-rakipi-frida-krifca-dhe/>

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm, me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, krahasuar me kolegët e tij, të cilët ndodheshin në të njëjtat kushte me të, sa i takon procedurës së ecurisë disiplinore.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*.

Doktrina kushtetuese, e trajton të drejtën e individit për punë, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese.¹³

Gjykata Kushtetuese¹⁴, ka mbajtur qëndrimin se: *“E drejta për punë, që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, përbën një të drejtë të individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës.*

Kjo e drejtë e individit për të përfutur me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi.

E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkuptojnë të drejtën e individit për të ushtruar çdo veprimtari të ligjshme që i sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që Kushtetuta i jep individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit ka si qëllim mbrojtjen e këtyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit.

Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar vetëm si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që neni 49 i Kushtetutës i bën të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë”.

¹³ Livio Paladini, “Diritto Costituzionale”, CEDAM, Padova, 1991, fq. 166-175.

¹⁴ Vendimi nr. 20, datë 11.07.2006, i GJK.

Në rastin në fjalë kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis një institucioni publik dhe individit, e cila rregullohet nga ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9, të tij ka parashikuar se: “Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”. Ndërsa pika 5, germa c) e tij parashikon se: “Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:..c) kushtet e punës dhe punësimin, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, “E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shoqëruese shkaqesh, duke parashikuar dhe çdo status tjetër, si shkak të mbrojtur.

Ndërkohë Protokollit 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar:

“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;

b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;

c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;

d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, konkretisht, çështjes Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar, i cili ishte ankuar se shkarkimi i tij nga detyra ishte i motivuar për shkak të bindjeve të tij politike, GJEDNJ-ja është shprehur se: “...në mungesë të masave mbrojtëse, një sistem ligjor që lejon shkarkimin e punonjësit për shkak të anëtarësimit të punonjësit në një parti politike bart në vetvehte rrezikun potencial për abuzim të mundshëm”. GJEDNJ theksoi gjithashtu se e drejta e ankuesit për të kundërshtuar largimin e tij nga puna është e vlefshme, pavarësisht bindjeve të tij politike, duke cituar se kjo vjen nga mbrojtja dhe garancia që ofron Neni 11 i Konventës (KEDNJ)¹⁵.

¹⁵ “Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij. 2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejtë parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si: “*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*”¹⁶, i cili sanksionon të drejtën për punë në nenin 6, të tij. Sipas këtij akti ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut, i cili është ratifikuar nga vendi ynë, parashikohet se, e drejta për punë përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësinë e sigurimit të jetesës, duke punuar punën e pranuar lirisht dhe marrjen e masave të përshtatshme për ta mbrojtur këtë të drejtë.

Konventa nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës¹⁷ “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi.

Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes në barazi dhe mundësi ose trajnim në punësim dhe profesion.

*Karta Sociale Europiane*¹⁸ në nenin 1, pika 2, parashikon: “*Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2. të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...*” Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim¹⁹.

Ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin, parime të cilat janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si, çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Në nenin 3, pika 4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, parashikohet se: “*Diskriminim për shkak të shoqërimit*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin

Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore”

¹⁶ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

¹⁷ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

¹⁸ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

¹⁹ Shih: *Sidabras dhe Džiautas kundër Litanisë*, prg 30.

grupeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë”.

Në bazë të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD-së përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur ti mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së.

Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale (KEDS) gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar²⁰ ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër, në këtë rast Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, krahasuar me kolegët e tij, të cilët ndodheshin në të njëjtat kushte me të, sa i takon procedurës së ecurisë disiplinore.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Në të njëjtën frymë është dhe ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, i cili, në nenin 33, pikën 7/1 të tij, ka përcaktuar se: “*Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon*

²⁰Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “*Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”.

pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ-ja pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara²¹”.*

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues.

Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të padrejtë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.²²

²¹ GjedNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GjedNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GjedNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

²² https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është pikërisht bazuar në standartin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, krahasuar me kolegët e tij, të cilët ndodheshin në të njëjtat kushte me të, sa i takon procedurës së ecurisë disiplinore. Njëkohësisht, sa më sipër, rezultoi e provuar se ankuesi është anëtar i Lëvizjes Socialiste për Integrim, duke provuar në këtë mënyrë bindjet e tij politike. Ankuesi gjithashtu, ka parashtruar faktin se motra e tij, K. K. prej datës 14.10.2020, ka ushtruar funksionin e Kryetares, si dhe ka qenë kandidate për deputete në zgjedhjet parlamentare, për subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim, për Qarkun Durrës, duke provuar lidhjen familjare të tij. Sipas ankuesit, fakti që bindjet e tij politike janë të kundërta me ato titullarit të institucionit, kanë sjellë si pasojë trajtimin e tij të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm duke përfunduar marrëdhënien e tij të punës me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Rezulton se, përpara periudhës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në prill të vitit 2021, e motra e ankuesit, znj. K. K., referuar publikimeve të bëra në media, më datë 14.10.2020, është emëruar²³ në pozicionin e Kryetares së subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, për Qarkun Durrës. Gjithashtu, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, znj. K. K., ka qenë kandidate²⁴ për deputete e LSI-s në Qarkun e Durrësit.

Gjithashtu, rezulton se më datë 15.07.2019, në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve është emëruar²⁵ znj. D. I., pozicion të cilin e ka mbajtur deri në muajin shtator 2021 kur është emëruar²⁶ Ministre e Financave dhe Ekonomisë. Sa i përket aktivitetit politik të saj, evidentohet se znj. D. I., është e deleguara²⁷ e subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë në Njësinë Administrative Nr. 5 në Tiranë.

Nga provat e administruara, rezulton që shtetasi A. Ç., i cili mban detyrën e Nëndrejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, ka qenë pjesë²⁸ e strukturave të Partisë Socialiste të Shqipërisë.

²³ <https://www.gazetatema.net/2020/10/14/pas-tradhetise-se-lefter-kokes-lsi-emeron-drejtuesit-e-rinj-ne-durres-ja-emrat>

²⁴ <https://telegraf.al/politike/lsi-durres-kontjana-kuci-kapitullimi-perfundimtar-i-rilindjes-vjen-me-25-prill/>

²⁵ <https://www.balkanweb.com/emerohet-drejtori-i-ri-i-tatimeve-nje-grua-merr-postin-emri/>

²⁶ <https://kryeministria.al/ministrat/delina-ibrahimaj/>

²⁷ <https://www.faxweb.al/rama-ben-ndryshime-te-te-deleguarve-per-tiranen-marrin-bazen-ne-dore-lindita-nikolla-orlando-rakipi-frida-krifca-dhe/>

²⁸ <https://www.almediapost.com/politike/avokati-i-pd-se-ne-kas-flet-me-emra-drejtuesit-dhe-nepunesit-lokale-qe-u-perfshine-ne-shit-blerjen-e-votave-ne-durres/2021/05/24/>
<https://kryefjala.com/lajme/lajme-nga-vendi/denoncimi-alban-cela-kusheriri-i-ard-celes-nendrejtor-i-pergjithshem-i-tatimeve-kerconon-cdo-dite-bizneset-ne-durres-ne-kembim-te-votes/>
<https://tvklan.al/deri-ne-1-mije-euro-per-familje-pd-si-u-ble-vota-ne-durres/>

Për faktet që janë të njohura publikisht, bazuar në nenin 80/3 të Kodit të Procedurave Administrative, ku sanksionohet se: *"Për faktet të cilat janë të njohura publikisht, si dhe për ato fakte të cilat janë të ditura për organin administrativ për shkak të funksioneve të tij, nuk nevojitet verifikim"*, nuk lind nevoja për verifikim.

Pra, nga sa më sipërcituar, znj. D. I., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe z. A. Ç., në cilësinë e Nëndrejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, kanë patur një aktivitet të njohur politik, si pjesë e strukturave të Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Për trajtimin diskriminues në pjesën dërrmuese të çështjeve nuk ekzistojnë prova të drejtpërdrejta. Bindjet politike përbëjnë një të dhënë sensitive të personit dhe shpesh herë punëdhënësi mbrohet me faktin se ai e ka të ndaluar që të mbledhë të dhëna për bindjet politike të punëmarrësve, e për rrjedhojë ai nuk ka si të ketë dijeni për bindjet politike të punëmarrësve të vet. Në lidhje me këtë moment, Komisioneri vlerëson se, provat rrethimore mund të hedhin poshtë pretendimin e punëdhënësit se nuk ka patur dijeni për bindjet politike të punonjësit dhe për këtë arsye të provohet se punëdhënësi ka patur dijeni.

Sa më sipër dhe nga provat e administruara, Komisioneri vlerëson se, aktiviteti dhe bindjet politike të motrës së subjektit ankues, janë fakte të njohura botërisht. Në këtë kuptim, jemi në kushtet kur shkakun e diskriminimit nuk e mbart drejtpërdrejtë ankuesi, por personi që shoqërohet apo supozohet që shoqërohet me të. Në rastin konkret, rezulton i provuar fakti që bindjet politike i mbart K. K., si përfaqësuese e lartë e Lëvizjes Socialiste për Integrim, për qarkun e Durrësit, vëllai i së cilës është ankuesi. Bazuar në informacionin e administruar, rezulton se ai ka qenë i anëtarësuar në LSI prej vitit 2016 e në vijim dhe ka pohuar se bindjet e tij politike nuk i ka bërë publike në asnjë moment. Në këtë kuptim dhe referuar provave të administruara, rezulton se menjëherë pasi është bërë publik fakti se motra e subjektit ankues (prej datës 14.10.2020), është emëruar në funksionin e Kryetares së LSI-s për qarkun e Durrësit, si dhe kandidimit (të bërë publik²⁹ në datë 23.03.2021) të saj për deputete në zgjedhjet parlamentare, për këtë subjekt politik, ndaj tij kanë nisur procedurat disiplinore për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Duke iu referuar faktit se procedimi disiplinor ndaj ankuesit, ka nisur pak kohë pas bërjes publike të faktit që e motra e ankuesit është emëruar Kryetare e subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, për qarkun e Durrësit dhe duke qenë se në raport me punonjësit e tjerë, për të njëjtat sjellje, vetëm për ankuesin është propozuar masa disiplinore e largimit nga puna, pa marrë parasysh vlerësimin vjetor të punës apo faktin nëse ka patur masa disiplinore të tjera në fuqi, Komisioneri krijon dyshimin e arsyeshëm se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, krahasuar me kolegët e tij, të cilët ndodheshin në të njëjtat kushte me të, sa i takon procedurës së ecurisë disiplinore.

²⁹ <https://euronews.al/al/vendi/politike/2021/03/17/kandidatet-e-lsi-se-per-zgjedhjet-e-25-prillit-lista-e-plate/>

Në këtë situatë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ndodhet në kushtet që ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar i konstatuar më sipër, nuk është diskriminues.

Ndërkohë, për të justifikuar trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm, krahasuar me kolegët e tij, të cilët ndodheshin në të njëjtat kushte me të, sa i takon procedurës së ecurisë disiplinore, DPT pretendoi se shkak i largimit nga puna të ankuesit ka qenë mospërbushja e detyrave funksionale në cilësinë e përgjegjës të grupit, fakt i cili nuk u konstatua dhe nuk u provua në asnjë moment gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës që ankuesi të ketë mbajtur në ndonjë moment këtë pozicion pune, atë të përgjegjës të grupit.

Pra, siç shihet qartë nga dinamika dhe kronologjia e zhvillimit të ngjarjeve, analizimi i fakteve në tërësinë e tyre; pasojat negative të subjektit ankues nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, i kanë ardhur menjëherë pasi është bërë publik fakti se e motra, është emëruar në funksionin e Kryetares së LSI-s dhe ka kandiduar për deputete në zgjedhjet parlamentare, për këtë subjekt politik, për Qarkun e Durrësit.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nuk u arrit të provohet:

1. Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesi dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë nga ana e punëdhënësit, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
2. Që për veprimet dhe mosveprimet e këtij subjekti kundrejt ankuesit ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime dhe mosveprime ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale.

Sa më sipër Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për shkak të bindjeve dhe aktivitetit politik të motrës së tij. Për rrjedhojë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka shkelur dispozitat e Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenin 3, pikat 1 dhe 2, dhe nenin 12, pika 1, gërma “c”.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstaton se K. K., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, trajtim i cili ka ardhur si pasojë direkte e bindjeve dhe aktivitetit politik të motrës së tij.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”.

Në nenin 33, pika 12, të LMD-së, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përputhje me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë e largimin e ankuesit nga detyra, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur duke e rikthyer atë në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, të ankuesit K. K., në të drejtën për punësim, *në formën e shoqërimit*, për shkak të bindjeve dhe aktivitetit politik të motrës së tij, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
2. Në referim të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindjet politike)

(Fusha: Punësim)

(Forma: Në formën e shoqërimit)